



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 508/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Adnan Konushevcu dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik koalicioni NISMA-AKR-PD me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.508/2019 e datës 23.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që të shpallet i vlefshëm një fletëvotim në Vendvotimin 2510D/04R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 23.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.508/2019 nga subjekti politik koalicioni Nisma –AKR-PD, në të cilën pretendon se gjatë procesit të rinumërimit me datë 23.11.2019, fletëvotimi me numër 2510D/04R, është shpallur i pavlefshëm pa të drejtë nga zyrtarët e numërimit në QNR. Paraqitësi në ankesë vlerëson se bazuar në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së për zgjedhjet e 6 Tetorit 2019, sipas shtojcës nr.7(Mostër e fletëvotimit të vlefshëm), ky fletëvotim duhet të shpallet i vlefshëm për arsye se votimi përmes një "TIKU" është i vendosur në mënyrë të rregullt në hapësirën e Koalicionit NISMA-AKR-PD nr.122, pra këtu kemi të bëjmë me votim të rregullt dhe qëllim të qartë të votuesit, dhe se shenja apo votimi që vërehet në rubrikën e hapësirës të subjektit politik me nr.131, vërehet qartë se nuk është bërë nga votuesi, por kemi të bëjmë me ndërhyrje nga një dorë e tretë, theksohet në ankesë. Paraqitësi në ankesë propozon që të aprovon ankesën dhe se ky fletëvotim nga vendvotimi nr.2510D/04R, të shpallet i vlefshëm dhe të obligojë KQZ-QNR që ta vendos në rezultatin përfundimtar të koalicionit NISMA-AKR-PD.

Si dëshmi për pretendimet e tyre ankesës i kanë bashkangjitur kopjen e fletëvotimit të kontestuar.

Në përgjigje në ankesë të datës 23.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në rastin e vendvotimit 2510D/04R thekson se fletëvotimi është shpallur i pavlefshëm për arsye se tek Subjekti 122 votuesi ka shënjuar me "TIK" ndërsa në katrorin e Subjektit 131 ka një vijë. Kjo është arsyeja pse fletëvotimi në fjalë është shpallur i pavlefshëm.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se në vendvotimin me numër 2510D/04R, me rastin e rinumërimit në QNR, është shpallur i pavlefshëm një fletëvotim në të cilin votuesi gjatë votimit ka votuar për subjektin politik koalicioni NISMA-AKR-PD, mirëpo në këtë fletëvotim kemi edhe një shenjë të vendosur në rubrikën e subjektit politik me numër 131.

Subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenit 8 par. 1 të Rregullës Zgjedhore NR. 06/2013, brenda afatit ligjor ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i vlefshëm.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se pa të drejtë një fletëvotim i gjetur në kutinë e vendvotimit 2510D/04R, është shpallur i pavlefshëm, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se nuk e përmbush asnjërin kriter të vlefshmërisë. Nga ekzaminimi i fletëvotimit shihet se shenja e tikut është vendosur në rubrikën e subjektit politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, mirëpo në po këtë fletëvotim është prekur edhe rubrika e subjektit politik me nr.131, veprim ky i cili e bën të pavlefshëm fletëvotimin në fjalë sepse në rastin konkret nuk dihet qartë qëllimi i votuesit me rastin e votimit.

Nga sa u tha më sipër e në kuptim të nenit 117 dhe 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 508/2019 më datë 24.11.2019

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.